



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2014-35

M.N

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 21 korrik 2014. Ajo ishte parashtruar nga M.N. përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, X.Y.
2. Ankuesi ka kërkuar që identiteti i tij mos të bëhet publik. Duke shqyrtuar çështjen, posaçërisht natyrën e akuzave që bëhen, Paneli është i bindur që duhej t'i pranohej kjo kërkesë.
3. Me 9 janar 2017, znj. Elka Ermenkova është tërhequr nga kjo lëndë, për shkak të konfliktit të interesit dhe ajo nuk ka marrë pjesë në

shqyrtimin e lëndës, në përputhje me Rregullën 12(1)(1) të Rregullores së Punës së Panelit. Ajo ishte zëvendësuar nga znj. Anna Bednarek.

4. Me 8 shkurt 2017, parashtruesi i ankesës në një letër ka kërkuar nga Paneli që t'i dëgjoj dy dëshmitarë.

II. FAKTET

5. Ankuesi ishte dënuar lidhur me të ashtuquajturin “rasti i shpërthimit të bombës në bulevardin Bill Klinton”.
6. Me 7 shkurt 2011, ankuesi ishte dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për vrasje të rëndë, tentim vrasje të rëndë dhe mbajtje në pronësi, kontroll dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në të ashtuquajturin “rasti i vrasjes së trefishtë”.
7. Me 12 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka konfirmuar këtë aktgjykim.
8. Përsëri me 24 shtator 2012 në një procedurë të dytë ankimi, Gjykata Supreme e Kosovës ka konfirmuar këtë aktgjykim.
9. Me 31 janar 2014, Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë si të vonuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Shtetit.

III. ANKESAT

10. Ankesa pretendon se për shkak të korrupsionit ai nuk ka pasur gjykim të drejtë. Mbi këtë bazë, ai kërkon nga Paneli që të shqyrtojë rastin e tij dhe t'i rihap procedurat.
11. Për më tepër, ankuesi pohon se bashkëpunimi nga ana e tij në hetimet nga EULEX-i e ka vënë atë dhe familjen e tij në rrezik dhe se ai nuk është duke marrë ndonjë mbrojtje nga EULEX-i.
12. Ankuesi pohon se një prokuror i EULEX-it ishte duke ndërmarrë hapa hetimorë në mënyrë që ta rihapte rastin e “vrasjes së trefishtë”. Ai pohon se që nga ajo kohë hetuesi i ngarkuar dhe prokurori ishin ndikuar nga një person ose subjekt i pasaktësuar që mos të ndërmerret ndonjë veprim më shumë lidhur me këtë rast.
13. Ankuesi pohon se i ka ndihmuar EULEX-it të hetojë çështjen, mirëpo EULEX-i e ka lënë atë pa asnjë mbrojtje. Ai nuk i referohet ndonjë incidenti konkret të kërcënimit apo frikësimit, por pohon se “... do të mbajmë EULEX-i përgjegjës nëse diçka na ndodh neve dhe familjeve tona”. Po ashtu ai shpreh shqetësim të përgjithshëm rreth asaj se “çka

do të ndodhë lidhur me sigurinë tonë atëherë kur të largohet EULEX-i”.

IV. LIGJI

14. Ankuesi nuk i referohet ndonjë të drejte të njeriut të veçantë apo ndonjë dispozite të të drejtave të njeriut të shkelura nga EULEX-i. Në bazë të natyrës së ankesës, Paneli do të shqyrtojë rastin e tij sipas nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë), nenit 2 (e drejta për jetën) dhe nenit 3 (ndalimi i torturës) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Në këto dispozita për aq sa janë përkatëse thuhet:

Neni 6 E drejta për gjykim të drejtë

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale ndaj tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që vlerësohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale konsiderohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të dëshmohet sipas ligjit.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - (a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
 - b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën ligjore, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
 - d. të merr në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
 - e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 2 - E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji.

Neni 3 - Ndalimi i torturës

“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.

Dispozitat ekuivalente gjenden në instrumentet e tjera të të drejtave të njeriut të rëndësishme për punën e Panelit (shih p.sh. nenet 7, 6 dhe 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike).

15. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut të dhëna në Konceptin e Llogaridhënies së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 në OPLAN-in e EULEX-it Kosovë mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
16. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës.
17. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana. Në përputhje me aktin e themelimit, referuar në paragrafin 15 më lartë, Rregulli 25 e tutje parasheh që Paneli nuk është kompetent të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
18. Lidhur me kërkesën (shih më lartë paragrafin 10) se Paneli duhet të shqyrtojë dosjen e lëndës dhe të rihap procedurat, Paneli thekson se ankuesi apelon vendimet e dhëna nga gjykatat e Kosovës dhe duket se apelon pajtueshmërinë e këtyre vendimeve me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut, në veçanti me garancitë procedurale të së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuara me nenin 6 të Konventës.
19. Paneli në shumë raste ka gjetur, në bazë të rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it Kosovë,

se në parim nuk ka juridiksion rreth aspekteve administrative e as aspekteve gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Si në këtë lëndë, fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih midis të tjerash vendimet e tjera: *(ndër të tjera shih Rifat Kadribasic kundër EULEX-it, nr. 2014-09, of 10 nëntor 2014, § 11, Shaban Kadriu kundër EULEX-it, 2013-27, 27 maj 2014, § 17)*).

20. Ankuesi nuk ka shpjeguar se si shqyrtimi dhe rihapja e procedurës do të hynte në kuadër të kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë. Paneli ka theksuar në një numër rastesh se do të kishte kompetencë për të shqyrtuar aktet dhe vendimet e prokurorit publik, aty ku akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen prokurorit nuk do të ishin adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore (p.sh. shih *E kundër EULEX-it, 2012-17, 30 gusht 2013, par. 22 e tutje*). Në këtë rast të veçantë, ankesa nuk ka arritur të bind Panelin se gjykatat kompetente të Kosovës nuk kanë adresuar plotësisht dhe në mënyrë të duhur ndonjë prej argumenteve të të drejtave të njeriut që ai i kishte ngritura pranë tyre.
21. Rezulton se çështjet e ngritura nga ankuesi nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Si pasojë, ato janë jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it.
22. Lidhur me pretendimin (shih më lartë paragrafin 11-13) se EULEX-i e ka lënë atë pa asnjë mbrojtje, pavarësisht rrezikut aktual për të dhe familjen e tij, Paneli vëren si në vijim. Së pari, ankuesi nuk ka vërtetuar se është bërë ndonjë kërcënim konkret ndaj tij apo ndaj familjes së tij dhe gjithashtu nuk ka vërtetuar se ndonjë rrezik i tillë, nëse ekziston, do të ketë lindur nga asistenca e pretenduar ndaj EULEX-it (për shembull shih *W.D. kundër EULEX-it, 2015-13, 1 mars 2016, § 21 dhe 22*). Së dyti, nuk është treguar se ai ka kërkuar nga EULEX-i ndonjë lloj mbrojtjeje apo, nëse po, se EULEX-i ka vepruar në mënyrë të paarsyeshme në përgjigjen ndaj një kërkesë të tillë. Në këto rrethana, duke pasur parasysh informacionin pranë Panelit, ajo pjesë e ankesës mund të thuhet se është qartas e pabazuar.
23. Në lidhje me kërkesën e ankuesit (paragrafi 4 më lartë) që Paneli t'i dëgjonte dy dëshmitarë, Paneli nuk ka nevojë të vendosë këtu nëse do ta kishte këtë autoritet në pajtim me rregullën 33 të Rregullores së tij të Punës. Në rrethanat e veçanta të këtij rasti, Paneli në të vërtetë nuk është bindur që është e nevojshme ndonjë dëshmi shtesë për të vendosur rreth pranueshmërisë së këtij rasti.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë pjesë të ankesës, pasi ankesa bie jashtë juridiksionit të tij në kuptimin e rregullit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës dhe në lidhje me pjesën e mbetur të ankesës, e shpall atë qartas të pabazuara në pajtim me Rregullën 29 (e) të Rregullores së Punës, dhe prandaj

E SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese